



Republika e Kosovës
Ministria e Financave

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor Prill – Qershor, 2019

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë. Buletini gjithashtu përshkruan zhvillimet fiskale për shtetin si dhe parashikimet më të azhurnuara të Departamentit. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë edhe informativ dhe i arritshëm për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.

Përmbajtja

ZHVILLIMET E EKONOMISË SË JASHTME	3
SEKTORI REAL	4
Rritja Ekonomike	4
Inflacioni	6
SEKTORI I JASHTËM	8
Llogaria Rrjedhëse	8
Llogaria Financiare	9
Llogaria Kapitale	10
SEKTORI FINANCIAR	10
TREGU I PUNËS	11
Anketa e Fuqisë Punëtore 2018	11
KLIMA E BIZNESIT	11
Regjistri i bizneseve, TM2 2019	11
Anketa e Odës Ekonomike të Kosovës TM2 2019	12
FINANCAT PUBLIKE	12
Të dhënat fiskale	12
Bilanci i përgjithshëm buxhetor	13
INFORMATA TË TJERA: Projektligjet e reja në fushën e tatimeve dhe doganës	13

ZHVILLIMET E EKONOMISË SË JASHTME

Sikur në TM1, edhe në tremujorin e dytë të vitit 2019 rritja ekonomike botërore mbetet e ngadalësuar. Ky ngadalësim vjen së pari si pasojë e rritjes së mëturjes së tarifave në importe të caktuara nga SHBA dhe Kina ndaj njëra tjetrës. Arsyet shtesë të këtij ngadalësimi janë pasiguria e vazhdueshme nga Brexit dhe lëvizjet në çmimet e energjisë. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, BPV-ja botërore për vitet 2019 dhe 2020 është rishikuar për poshtë me 0.1 pikë të përqindjes, duke u luhatur rreth vlerës 3.2% dhe 3.5%, respektivisht. Vlen të ceket se gjatë kësaj periudhe, investimet dhe kërkesa për produkte afatgjata të konsumatorëve (sikurse veturat apo pajisjet shtëpiake) kanë rënë në të gjitha ekonomitë, qofshin ato të zhvilluara apo në zhvillim. Ndërkohë, përmirësimi i aktivitetit ekonomik në nivel global nga viti 2019 në vitin 2020 bazohet në supozimin se problemet tregtare do të zgjidhen gjatë kësaj kohe¹.

Pasiguria e krijuar nga problemet tregtare në ekonominë botërore (dhe ndikimi i tyre negativ në sektorin e prodhimit në Bashkimin Evropian) dhe një Brexit 'pa marrëveshje' kanë ndikuar edhe në Bashkimin Evropian. Këta dy faktorë janë risqet kyçe që mund të ndikojnë në ngadalësimin e mëturjes të zhvillimit ekonomik. Sidoqoftë, kërkesa e qëndrueshme vendore dhe qëndrueshmëria e sektorit të shërbimeve përbëjnë kontribuuesit kryesorë në nxitjen e zhvillimit ekonomik gjatë kësaj periudhe².

Inflacioni në eurozonë ishte 1.3% në qershor të vitit 2019 (0.1 pikë të përqindjes më i ulët se në mars), me kontribut më të madh të ardhur nga komponenti i shërbimeve (+0.73 p.p.), pasuar nga ushqimi, pijet alkoolike dhe duhani (+0.30 p.p.), energjia (+0.17 p.p.) dhe produktet industriale (duke përjashtuar energjinë) (+0.07 p.p.)³. Normat më të ulëta të inflacionit u regjistruan në Greqi (0.2%), Qipro (0.3%), Danimarkë e Kroaca (të dyja me nga 0.5%). Në anën tjetër, normat më të larta të inflacionit u regjistruan në Rumani (3.9%), Hungari (3.4%), dhe Letoni (3.1%)⁴.

Krahasuar me TM1, BPV-ja e përshtatur sezonalisht u rrit në eurozonë dhe BE28 gjatë TM2. Po ashtu, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, BPV-ja e përshtatur sezonalisht u rrit me 1.1% dhe 1.3% në eurozonë dhe BE28, respektivisht⁵.

Tabela 1 Indikatorët kryesorë të ekonomisë botërore

v-m-v, %, nëse nuk ceket ndryshe	2018	2019	2020
BPV Botërore ^(FMN WEO Korrik)	3.6	3.2	3.5
Inflacioni, çmimet mesatare të konsumit ^(FMN WEO Prill)	3.6	3.6	3.6
BPV në Euro Zonë ^(ECB Parashikimet Qershor 2019)	1.8	1.2	1.4
Inflacioni në Euro Zonë ^(ECB Parashikimet Qershor 2019)	1.8	1.3	1.4

¹ WEO Korrik 2019

² Komisioni Evropian Korrik 2019

³ Eurostat Qershor 2019

⁴ Ibid.

⁵ Ibid.

Në krahasim me TM1, çmimet e mallrave bazë gjatë TM2 në përgjithësi janë ngritur (duke përfshirë çmimet e ushqimit, produkteve bujqësore, dhe metaleve ndër tjera). Ndryshe prej trendit rritës të çmimeve të mallrave bazë në përgjithësi, çmimet e energjisë kanë pësuar një rënie prej 0.2% gjatë kësaj periudhe, krahasuar me periudhën paraprake.

Tabela 2 Çmimet e mallrave bazë

	2017	2018				2019	
	Mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2
Indeksi i çmimeve të të gjitha mallrave bazë (FMN çmimet e komoditeteve)	113.6	127.8	131.4	130.5	124.0	118.9	120.2
Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe pijeve (FMN çmimet e komoditeteve)	103.2	105.4	106.0	98.7	98.2	98.9	99.8
Çmimi i naftës bruto, Brent (BB Pink Sheet)	54.4	67	74.5	75.5	67.4	63.3	68.3
Nikel, \$ për ton metrik (BB Pink Sheet)	10,159	13,284	14,470	13,239	11,463	12,412	12,224

SEKTORI REAL

Rritja Ekonomike

Ecuria Makroekonomike 2019


Në tremujorin e parë të vitit 2019, ekonomia e Kosovës u rrit me 4.1% (v-m-v) në terma realë dhe me 6.1% (v-m-v) në terma nominalë.

Norma reale e rritjes në tremujorin e parë të 2019-ës kryesisht i atribuohet konsumit privat (me një kontribut prej rreth 4.62 pikë përqindje); investimeve totale (me 1.98 p.p.) dhe konsumit publik (me 0.55 p.p.); ndërkohë që kontributi i eksporteve neto të mallrave dhe shërbimeve vazhdoi të ishte negativ (rreth 3.09 p.p.).


Në tremujorin e parë të 2019-ës, bazuar në ndarjen e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike, sektori “tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” vazhdon të ketë kontributin më të lartë në rritjen reale të BPV-së (rreth 0.47 pikë përqindjeje), duke u ndjekur nga sektori “furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë” me rreth 0.37 pp, ndërkohë që sektori i “ndërtimit” dhe “industrisë (përpunuese dhe nxjerrëse)” shënoi kontribut të ngjashëm pozitiv, me rreth 0.14 p.p dhe 0.19 p.p, respektivisht; ndërkohë që kontributi i sektorit të bujqësisë ishte lehtësisht nën zero (-0.02%) dhe kontributi i sektorit të shërbimeve ishte neglizhent⁶ (ndjeshëm më ulët se periudhat paraprake).

⁶ Sektori i shërbimeve përfshin kategoritë: “transporti dhe magazinimi”; “hotelet dhe restorantet”; “aktivitetet financiare dhe te sigurimit”; “afarizmi me pasuri te patundshme”, “administrimi publik” dhe “shërbime të tjera”.

Grafiku 1 Kontributet në BPV



Grafiku 2 BPV reale sipas aktiviteteve



Bazuar në të dhënat preliminare tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), rritja reale e BPV-së gjatë gjithë vitit 2018 ishte 3.9% krahasuar me vitin paraprak. Bazuar në të dhënat historike, publikimet vjetore për rritjen ekonomike janë zakonisht më të larta se ato tremujore.⁷ Prandaj, duke gjykuar mbi bazën e rishikimeve të rritjes ekonomike nga ASK dhe në ecurinë e burimeve të financimit të konsumit dhe investimeve dhe në ecurinë e bilancit tregtar pritet që rritja vjetore reale për vitin 2018 të jetë më e lartë, rreth 4.3%.

Pritjet për ecurinë makroekonomike për TM2 2019

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV në tremujorin e dytë të 2019-ës, indikatorët indirekt të kërkesës agregate japin sinjale për rritje më të ngadaltë se në tremujorin paraardhës (2019TM1).

- Konsumi privat në tremujorin e dytë të 2019-ës pritet të shënojë një rritje më të ngadaltë, si rezultat i ritmit të: *i*) rritjes së importeve të mallrave të konsumit me 2.6%; *ii*) rritjes së mbledhjes së TVSH-së me 1.52%; dhe *iii*) rritjes së remitencave me 6.7%. Të gjitha këto norma rritjeje qëndrojnë poshtë nivelit të tyre respektiv të regjistruar në tremujorin e kaluar (2019T1).
- Konsumi publik⁸ është përshpejtuar në 6.9% në tremujorin e dytë të 2019 (v-m-v).
- Sinjalet për investimet private sugjerojnë një normë rritje më të ulët të tyre, si rezultat i: *i*) rënies së importeve të mallrave kapitale me 4.2%- nxitur gjithashtu nga një dinamikë më e ngadalësuar e ekzekutimit të shpenzimeve publike kapitale; dhe *ii*) rritjes së investimeve të huaja direkte me rreth 0.2%. Megjithatë, indeksi i klimës së biznesit në 2019TM2 është përmirësuar krahasuar me tremujorin e vitit të mëparshëm (2018T2) dhe kredia e re lëshuar për qëllime investimi është gjallëruar në një normë rritje prej 1.9% (v-m-v).
- Investimet publike në tremujorin e dytë të 2019-ës janë më të ulëta se ato të tremujorit të dytë të vitit të kaluar, megjithatë dinamika e tyre është përmirësuar krahasuar me 2019T1.
- Bilanci (deficiti) tregtar i mallrave dhe shërbimeve në muajt prill-maj 2019 luhatet rreth nivelit të ngjashëm të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

⁷ Për 2016 dhe 2017, rritja reale ekonomike bazuar në të dhëna tremujore ishte 3.4% dhe 3.7% respektivisht, të cilat u rishikuan për lartë në publikimet vjetore në 4.1% dhe 4.2%, respektivisht.

⁸ Konsumi Publik përfshin dy kategori të shpenzimeve: “paga dhe mëditje” dhe “mallra dhe shërbime”.

Parashikimet më të fundit ekonomike

Ministria e Financave publikoi parashikimet makroekonomike më të fundit në muajin prill, si pjesë e KASH 2020-2022.⁹ Këto parashikime së bashku me ato të institucioneve të tjera janë të përshkruara në tabelën më poshtë.

Tabela 3 Parashikimet e institucioneve të tjera

Rritja e BPV % Parashikime	Data e Publikimit	2019	2020	2021	2022
Ministria e Financave	Prill 2019 ¹⁰	4.7	4.7	4.5	4.6
Banka Qendrore e Kosovës	Qershor 2019	4.2	n/a	n/a	n/a
FMN	Prill 2019 ¹¹	4.0	4.0	4.0	4.0
Banka Botërore	Mars 2019 ¹²	4.4	4.5	n/a	n/a
FMN BPV nominale në mln Euro	Prill 2019	7,106.0	7,507.0	7,944.0	8,420.0
MF BPV nominale në mln Euro	Prill 2019	7,123.0	7,520.4	7,945.7	8,392.2

Inflacioni

Në TM2 2019, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit për 3.3% në terma vjetorë. Kjo normë është më e lartë se norma e inflacionit e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth 0.72%) dhe mbi normën mesatare për tërë vitin 2018 (1.1%). Dinamika mujore e tendencës rritëse të inflacionit në tremujorin e dytë të 2019-ës shfaq shenja ngadalësimi, duke shënuar një normë vjetore prej 3.4%, 3.4% dhe 3.0% në muajt prill, maj dhe qershor, respektivisht.

Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë ishin:

- Kategoria e ushqimit me 2.53 p.p. (kryesisht nga çmimet e "bukës dhe drithërave", "perimeve" dhe "mishit" ndërsa "frutat" vazhduan kontributin e tyre negativ);
- Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit me 0.15 p.p.;
- Transporti me 0.27 p.p. (kryesisht nga kategoria "operimi i pajisjeve të transportit personal");

Inflacioni bazë¹³ në tremujorin e dytë 2019, i matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe "transporti", shënoi një rritje vjetore prej 1.5%, që është më e ulët se sa inflacioni total (3.3%), por më e lartë se vlera e vet mesatare e regjistruar në vitin 2018 (-0.1%).

⁹ Këto parashikime do të jenë subjekt i rishikimit në muajin tetor, që përkon me procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2019.


¹⁰ MTEF 2020-2022

¹¹ World Economic Outlook


¹² <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/10/04/growth-in-kosovo-maintains-positive-momentum-says-World-bank>

¹³ Inflacioni bazë mat ndryshimin e çmimeve të produkteve të shportës së konsumatorit, duke përjashtuar luhatshmërinë e përkohshme dhe tranzitore, e cila kryesisht karakterizon kategorinë e ushqimeve apo të energjisë.

Grafiku 3 Inflacioni total ndaj inflacionit bazë



Grafiku 4 Kontributi i inflacionit të treg. dhe patregt.



Siç shihet në grafikun 4, komponenti i inflacionit të tregtueshëm¹⁴ vazhdon të përcaktojë sjelljen e inflacionit total dhe vlerësohet të ketë një kontribut rreth 2.7 pikë të përqindjes, ndërkohë që kontributi i komponentit të pa-tregtueshëm është i ulët.

Tabela 4 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor

Nën kategoritë kryesore të IÇK	2017	2018				2019	
	mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	0.60	0.24	0.25	0.87	1.12	2.54	2.54
<i>prej të cilave: Ushqimi</i>	0.46	0.19	0.27	0.89	1.15	2.51	2.53
<i>Buka dhe Drithërat</i>	0.06	0.22	0.14	0.13	0.38	1.08	1.28
<i>Pemët</i>	0.12	0.18	-0.02	-0.05	-0.19	-0.20	-0.15
<i>Perimet</i>	0.05	-0.10	0.12	0.43	0.46	0.93	0.66
Pijet alkoolike dhe duhani	0.18	0.09	0.13	0.13	0.16	0.13	0.15
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.19	0.10	0.09	0.09	0.08	0.11	0.12
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	0.36	0.04	0.37	0.75	0.83	0.40	0.25
IÇK (v-m-v, %)	1.47	-0.03	0.72	1.38	2.16	3.20	3.26

¹⁴ Inflacioni i tregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që janë të ekspozuara ndaj tregtisë në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht çmimet e tyre nuk ndikohen nga zhvillimet në tregun lokal. Ndërsa, inflacioni i patregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ndikohen nga tregu i brendshëm lokal.

SEKTORI I JASHTËM

Llogaria Rrjedhëse

Deficiti tregtar i mallrave në tremujorin e dytë të vitit 2019 është ende i lartë duke arritur vlerën 791.4 milionë €.

- Importi i mallrave gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 shënoi rritje të lehtë prej 0.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritje më të theksuar shënuan kategoritë e importeve të mjeteve të transportit (15.8%, *v-m-v*); e produkteve minerale (6.8%, *v-m-v*); dhe kafshëve të gjalla dhe produkteve blegtorale (16.0%, *v-m-v*), e cila u kundërveprua nga rënia në kategoritë “Makineritë, veglat, pajisjet elektrike” dhe “Metalet bazë dhe artikujt prej tyre” të cilat shënuan rënie me rreth 15.8% dhe 2.5%, respektivisht.
- Eksportet e mallrave gjatë tremujorit të dytë 2019 shënuan një rritje prej 5.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Një rritje e tillë paraqet një përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me ecurinë e dobët të eksporteve në vitin 2018 (rënie vjetore prej 2.8%), për shkak të ngadalësimit në eksportet e metaleve bazë dhe produkteve minerale. Rritja e eksporteve të mallrave në tremujorin e dytë 2019 është nxitur kryesisht nga një rritje e eksporteve të metaleve bazë (48.2%, *v-m-v*); eksporteve të plastikës (19.9%, *v-m-v*); dhe eksportet e artikujve ushqimor (18.6%, *v-m-v*). (ndikimi i çmimeve në eksport)


Suficiti tregtar i shërbimeve për periudhën prill-maj të vitit 2019¹⁵ është 71 milionë € dhe është rreth 44% më i lartë se bilanci në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Kjo reflekton rritje më të shpejtë të eksporteve të shërbimeve në krahasim me importet e shërbimeve.

- Eksporti i shërbimeve për periudhën prill-maj të vitit 2019 ishte 18.5% më i lartë se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të shërbimeve më të larta të udhëtimit.
- Importi i shërbimeve ishte 4.9% më i lartë se ai i të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së importit të shërbimeve të udhëtimit si dhe shërbimeve të transportit.

Si rezultat i zhvillimeve në totalin e importeve dhe eksporteve, bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve në periudhën prill-maj 2019 është përmirësuar me rreth 0.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

¹⁵ Të dhënat për tregtinë e shërbimeve janë të disponueshme vetëm për Prill-Maj2019

Grafiku 5 Tregtia e mallrave dhe shërbimeve



Bilanci i të ardhurave parësore për muajt prill-maj të vitit 2019 ka shfaqur rënie të lehtë, duke arritur një vlerë prej 32.2 milionë eurosh krahasuar me 33.1 milionë që ishte në periudhën e njëjtë të 2018, kryesisht si rezultat i të ardhurave më të ulëta nga kategoria e të ardhurave nga investimet.


Bilanci i të ardhurave dytësore për muajt prill-maj të vitit 2019 arriti vlerën prej 224.4 milionë €, që është 9.1% më i lartë se bilanci në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave neto (11.1%, v-m-v).

Si rezultat i zhvillimit të bilancit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, bilancit të të ardhurave parësore dhe dytësore, deficiti i llogarisë rrjedhëse për muajt prill-maj të vitit 2019 është -173.2 milionë €, që tregon përmirësim në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraparak kur bilanci i llogarisë rrjedhëse kishte vlerë prej -193.1 milionë €.

Llogaria Financiare

- Bilanci i llogarisë financiare për muajt prill-maj të vitit 2019 është përmirësuar me rreth 7 milionë €. Kjo pasqyron rritjen e aseteve rezervë neto, ndërsa bilanci i letrave me vlerë është ulur.
- Gjatë periudhës prill-maj të vitit 2019, hyrjet totale të IHD-ve arritën në rreth 39.3 milionë €, duke mbajtur nivelin e njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.
- Rreth 95% e totalit të investimeve të huaja direkte gjatë periudhës prill-maj të vitit 2019 u absorbua nga sektori i pasurive të paluajtshme dhe qiratë. Transporti dhe komunikimi vijon të jetë absorbuesi i dytë më i madh

Grafiku 6 Investimet e huaja direkte. mln Euro



i IHD-ve, duke përbërë rreth 16.8% të totalit të IHD-ve. Gjatë periudhës prill - maj 2019, pesha e kategorisë së energjetikës ndaj totalit është rritur ndjeshëm në 18% ndaj totalit të IHD-ve.

- Rritja e IHD-ve në tre kategoritë e lartpërmendura u kundërveprua nga rënia e IHD-ve në kategorinë e shërbimeve financiare dhe në kategorinë e shërbimeve tregtare.

Llogaria Kapitale

- Bilanci i llogarisë kapitale gjatë periudhës prill-maj është përmirësuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar
- Të hyrat nga transferet kapitale janë rritur për 7.4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përderisa daljet e transfereve kapitale janë zvogëluar për 21%(v-m-v).

SEKTORI FINANCIAR

- Tremujori i dytë i vitit 2019 paraqet një rritje të theksuar të depozitave të reja prej 22.6% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018. Rritje më e lartë vjetore është shënuar në depozitat e korporatave jo-financiare me 29.2% dhe në depozitat e ekonomive familjare me 19.2%.
- Kreditë e reja në tremujorin e dytë ishin 1.8% më të larta krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018, duke reflektuar një rritje të kredive hipotekare për 2.6%, rritje të kredive investuese me rreth 1.9%, ndërkohë që kreditë konsumuese shënuan rënie me rreth 4.9%.
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e dytë të vitit 2019 ishte mesatarisht 6.4%, ndërsa gjatë tremujorit të dytë të vitit të kaluar ajo ishte 6.7%. Kjo rënie u reflektua kryesisht në kreditë e lëshuara për individët, ndërsa kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare mbetën relativisht të njëjta.
- Norma e interesit për depozitat e reja ka qenë mesatarisht 1.4% në tremujorin e dytë të vitit 2019 krahasuar me 1.2% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, e cila është reflektuar pothuajse në të gjitha maturitetet.
- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 ishin 2.6% të totalit të kredive, duke treguar një përmirësim të lehtë nga tremujori i dytë i vitit të kaluar (2.9%).


Tabela 5 Indikatorët e Sektorit Financiar

	2017	2018				2019	
	Mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2
Depozitat e reja % Δ	-10.4	20.6	19.0	17.9	36.1	0.8	22.6
Kreditë e reja % Δ	13.7	14.6	12.3	-3.7	0.7	-5.0	1.8
Norma efektive e interesit në kredi	7.3	6.9	6.7	6.7	6.3	6.7	6.4
Norma efektive e interesit në	0.9	1.1	1.2	1.5	1.4	1.5	1.4
Kreditë jo-performuese	4.7	3.0	2.9	2.8	2.7	2.6	2.6

TREGU I PUNËS

Anketa e Fuqisë Punëtore 2019T1

Grafiku 7 Indikatorët e tregut të punës



○ Anketa e Fuqisë Punëtore për 2019T1 tregon se numri i të papunëve ishte rreth 13.4% më i ulët se në fundin e vitit 2018. Norma e papunësisë në 2019T1 rezultoi 26.9%, e cila është 2.7 pikë përqindje më e ulët se norma e shënuar në vitin 2018.¹⁶

○ Raporti i punësimit ndaj popullsisë ka arritur nivelin prej 28.2% në 2019 T1, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 28.8%. Për tremujorin e dytë të vitit

2019, të dhënat zyrtare nga ASK-ja nuk janë ende të disponueshme. Burimet e tjera e të dhënave për punësimin (nga ATK-ja) tregojnë se numri i të punësuarve gjatë 2019 T2 shënon rritje si në terma vjetorë ashtu dhe tremujorë.

○ Si rezultat i zhvillimeve në ecurinë e punësimit, papunësisë dhe atyre demografike, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, sipas ASK-së në 2019T1 ka një rënie të lehtë në 38.7% nga 40.9% në vitin 2018.

KLIMA E BIZNESIT

Regjistri i bizneseve, TM2 2019


- Numri i bizneseve të reja gjatë tremujorit të dytë të 2019-ës është 2,655 dhe është 1% më i lartë se numri i bizneseve të regjistruara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018.
- 590 biznese të reja janë regjistruar në kategorinë e tregtisë, 479 biznese të reja në kategorinë e prodhimit, 359 biznese të reja në akomodim dhe shërbime ushqimore, 247 biznese të reja në ndërtim dhe pjesa tjetër në kategori të tjera.
- Numri i bizneseve të shuara gjatë 2019T2 arriti gjithsej në 447, duke qëndruar 10% më lartë se numri i bizneseve të shuara në periudhën e njëjtë të një vitit më parë. Shuarja e bizneseve ka qenë më e theksuar në sektorin e tregtisë (rreth 1/3 e tyre). Si rezultat, numri i bizneseve neto gjatë periudhës raportuese ishte 2208.

¹⁶ Të dhënat vjetore mbi tregun e punës nga ASK-ja kanë ndryshime të lehta me të dhënat tremujore (më konkretisht krahasuar me të dhënat e tremujorit të katërt).


Anketa e Odës Ekonomike të Kosovës TM2 2019

- Rezultatet e indeksit të klimës së biznesit për tremujorin e dytë të vitit 2019 tregojnë se bizneset kanë pikëpamje të përgjithshme pozitive të klimës së biznesit dhe indeksi i klimës së biznesit është përmirësuar nga vlera 24 në tremujorin e dytë të vitit 2018 në vlerën 30 gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019.
- Të gjithë sektorët kanë pritshmëri pozitive për punësim për gjashtë muajt e ardhshëm.
- Të gjithë sektorët, veçanërisht sektori i shërbimeve, vlerësojnë klimën e biznesit si pozitive.


Grafiku 8 Klima e të bërit biznes



Grafiku 9. Pritjet për punësim



Grafiku 10. Vlerësimi i klimës së biznesit



FINANCAT PUBLIKE

Të dhënat fiskale


- Të hyrat e përgjithshme arritën në 465.0 milionë Euro gjatë tremujorit të dytë të 2019-ës, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.6% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak. Ky arkëtim paraqet një normë realizimi prej 97.0% të shumës së parashikuar për këtë periudhë.
- Të hyrat tatimore për këtë periudhë shënuan vlerën 412.4 milionë Euro ose një rritje prej 4.6% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak. Këto të hyra arritën 96.5% të të hyrave të parashikuara për këtë periudhë.
- Këto të hyra ishin kryesisht të nxitura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar që përbën rreth 49.8% të të hyrave tatimore, pasuar nga të hyrat nga akciza me rreth 25.5% e të hyrave tatimore.
- Të hyrat jo-tatimore për këtë periudhë rezultuan 52.6 milionë, me një rritje vjetore prej 14.5%. Këto të hyra tejkaluan parashikimet për 6.0%.

- Shpenzimet buxhetore për tremujorin e dytë arritën vlerën prej 476.2 milionë euro dhe ishin rreth 10.9% më të ulëta se sa projeksionet.


Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- Bilanci i përgjithshëm kumulativ buxhetor arriti në -16.6 milionë € ose sipas rregullës fiskale, suficit prej 8.8 milionë €, brenda rregullës fiskale.
- Bilanci përgjithshëm bankar në fund të tremujorit të dytë arriti vlerën prej 567.9 milionë euro ose 8.0% e BPV-së (duke respektuar rregullën fiskale prej më së paku 4.5%).
- Bilanci i përgjithshëm buxhetor për vitin 2019 pritet të arrijë deficitin prej 145.3 milionë euro ose 2.0% të BPV-së, ndërkohë që Bilanci Bankar parashikohet të arrijë në 340 milionë euro ose 4.8% e BPV-së për 2019.

Grafiku 11 Kontributet në të hyrat buxhetore



Grafiku 12 Kontributet në shpenzime buxhetore



INFORMATA TË TJERA: Projektligjet e reja në fushën e tatimeve dhe doganës

Në kuadër të reformave fiskale për përmirësimin e kushteve të favorshme të të bërit biznes, Ministria e Financave ka finalizuar projektligjet e reja në fushën e tatimeve dhe doganës. Ligjet e reja mbulojnë fushën e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, Tatimit në të Ardhurat Personale, Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Kodin e Doganave dhe Akcizës.

Arsyeshmëria e hartimit të këtyre projektligjeve i referohet avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore si dhe eliminimit të zbrazëtirave aktuale ligjore. Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave veçse është aprovuar nga kuvendi dhe është publikuar në gazetën zyrtare. Dy Projektligjet tjera (Tatimi në të Ardhurat Personale dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar) kanë marrë miratimin e Qeverisë dhe janë në pritje për leximet nga parlamenti; ndërsa Kodi i Doganave dhe Akcizës ka përfunduar procesin e hartimit.

1. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Gjatë analizave të bëra nga Ministria e Financave dhe ATK-ja, është konstatuar se zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka nevojë për ndryshime si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit në direktivat e BE-së.

Procedura e çregjistrimit është ndryshuar duke eliminuar afatin 2 mujor të hyrjes në fuqi të çregjistrimit pas kërkesës për çregjistrim dhe me dispozitën e re, çregjistrimi hyn në fuqi në atë moment kur dorëzohet kërkesa për çregjistrim.

Në të njëjtën kohë, gjatë hartimit janë marrë parasysh edhe kërkesa nga komuniteti i biznesit dhe janë ndryshuar normat e TVSH-së për disa produkte. Pas konsultimeve me Shoqatën e Mullisëve të Kosovës, shërbimi i bluarjes së drithërave është vendosur të tatóhet me normë të sheshtë (8%). Gjithashtu, “furnizimi i shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe bagazhit të tyre, me çmime të rregulluara nga autoriteti kompetent shtetëror” është bartur te norma e reduktuar në mënyrë që të mundësohet e drejta e zbritjes së TVSH-së.

“Librat, librat shkollorë dhe publikimet serike” janë liruar nga TVSH-ja, me qëllim që qasja në edukim të bëhet sa më e lehtë dhe më e lirë. Gjithashtu, është liruar edhe “furnizimi i mallrave të prodhuara në Kosovë që shfrytëzohen si lëndë e parë për procesin e prodhimit.” Kjo në mënyrë që të mos diskriminohen prodhuesit vendor të lëndës së parë nga vendimi 14/07 i Qeverisë, i cili liron lëndën e parë për subjektet prodhuese në import. Projektligji gjithashtu liron nga TVSH-ja transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe transportin e mallrave të tyre shoqëruese, në harmoni me direktivat e BE.

Sa i përket çështjeve administrative, është ndryshuar shuma e kreditimit e cila mund të kërkohet të rimburohet nga tre mijë euro (3,000) në një mijë euro (1,000) në mënyrë që bizneset e vogla të cilat janë në kreditim të kenë mundësi të rimburohen.

Është shtuar nen i ri i cili rregullon pagesën e TVSH-së në import, brenda vendit. Kjo risi do t'u mundësojë bizneseve që të shtyjnë pagesën e TVSH-së dhe ta paguajnë atë në ATK. Megjithatë është lejuar që bizneset në mënyrë vullnetare të vazhdojnë të bëjnë pagesën e TVSH-së në Doganë.

Projektligji parasheh edhe formimin e një njësie të TVSH-së si një organ që do të administrojë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Kjo ka ndodhur në mënyrë që të rritet efikasiteti i mbledhjes së TVSH-së si dhe të zvogëlohen barrierat administrative për bizneset e regjistruara në TVSH.

2. Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave(TAK) dhe Projektligji për Tatimin në të Ardhura Personale(TAP)

Ngjashëm me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, edhe Projektligji për Tatimin në të Ardhura Personale, adreson periudhën e bartjes së shumës së humbjes, e cila është ndryshuar nga gjashtë (6) periudha tatimore, deri në katër (4) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

“Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja”, janë qartësuar në mënyrë që të kuptohet se zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë dhe nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë apo jashtë Kosovës.

Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave gjithashtu ka adresuar një problem shumëvjeçar me të cilin janë përballur kompanitë e sigurimeve dhe bankat. Janë shtuar nenet dhe përkufizimet e qarta për “Provizionet për humbjet e pritura nga kreditë” dhe “Provizionet teknike dhe matematike”, të cilat mundësojnë që kompanitë e sigurimeve dhe bankat të taten në mënyrë të drejtë dhe të njëjtë si të gjitha bizneset tjera.

Projektligji për Tatimin në të Ardhura Personale gjithashtu përcakton që tatimi në burim për bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, të ulet nga 3% në 1%, me qëllim lehtësimin e barrës së tyre tatimore. Në të njëjtën kohë, ky projektligj mundëson që pjesa e sigurimeve shëndetësore të mos taten. Ndërsa, lidhur me tarifatat e rishikuara për udhëtime jashtë vendit, për qëllime tatimore mund të trajtohen vetëm shumatat e paguara që janë mbi tarifatat e aprovuara nga institucioni përkatës.

Gjithashtu në të dy ligjet (TAK dhe TAP), është mundësuar që të gjitha bizneset të përfitojnë nga Pushimet Tatimore, pavarësisht nëse janë të reja, apo jo, duke iu nënshtruar disa kritereve të cilat do të përcaktohen me akt nënligjor.

3. Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat është ndryshuar duke mundësuar lehtësira të reja për tatimpaguesit dhe thjeshtëzim të procedurave. Në të njëjtën kohë, është bërë edhe harmonizimi me ligjet e tjera, të cilat ndërlidhen me procedurat e Administratës Tatimore.

Në mënyrë që të eliminohen paqartësitë, është eliminuar kërkesa për t’u pajisur me Numër Fiskal për subjektet që veçse kërkohet të regjistrohen në ARBK dhe të pajisen me Numër Unik Identifikues të biznesit.

Në mënyrë që të luftohet ekonomia joformale projektligji ka përcaktuar që çdo transaksion i bërë mes personave që përfshihen në aktivitet ekonomik (biznes-biznes) që tejkalon shumën 300 Euro, të bëhet përmes llogarisë bankare.

Projektligji parasheh shkurtimin e afateve të kontrollit tatimor nga 6 vite në 4 vite dhe të korigjimeve të deklaratave nga tatimpaguesit nga 6 vite në 3 vite dhe gjithashtu kufizon vazhdimin e llogaritjes së interesit mbi borxhin tatimor për 6 vite.

Për të mundësuar rimbursim më të shpejtë të tatimpaguesit që janë në kreditim, është shkurtuar afati për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim nga 60 ditë në 30 ditë, duke qenë kështu edhe në përputhshmëri me rregulloren e brendshme të ATK-së për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim.

Sa i përket strukturës organizative të ATK-së është bërë harmonizimi me Ligjin për Zyrtarët Publik dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Si rrjedhojë, është përcaktuar që drejtori i ATK-së emërohet sipas këtyre ligjeve dhe që numri i zëvendës drejtorëve të ATK-së të jetë dy (2).

Duke marrë parasysh kërkesat e komunitetit të biznesit për ri funksionimin e Bordit të Ankesave për arsye të pengesave që janë hasur në Divizionin Fiskal në kuadër të gjykatës, është themeluar dhe është përcaktuar organizimi i Bordit për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të Ministrisë së Financave. Ky bord do të shqyrtojë ankesat ndaj ATK-së, Doganës dhe çështjet tjera lidhur me tatimet në vend. Në të njëjtën kohë, është ndryshuar kohëzgjatja e shqyrtimit të një ankese nga Njësia e Ankesave në ATK nga 60 ditë, në 45 ditë.

Projektligji gjithashtu mundëson zbritjen e ndëshkimeve prej (50%) nga shuma që duhet paguar nëse ajo pagesë bëhet brenda një afati prej 15 ditëve. Kjo në mënyrë që të nxiten tatimpaguesit të paguajnë borxhet dhe të ulet barra për pagesë për tatimpaguesit të cilët kryejnë pagesat në kohë.

4. Kodi i Doganave dhe Akcizës

Është hartuar Kodi i Doganave dhe Akcizës, i cili synon reformimin e sistemit doganor përmes instrumenteve të reja të cilat janë në implementim edhe në vendet e BE-së. Qëllimi i këtij versioni të ri të Kodit është që biznesi sa më lirshëm të bëjë qarkullimin e mallit përtej vijës doganore (kufitare), me një kosto sa më të vogël dhe me sa më pak procedura burokratike.

Aspektet më të rëndësishme të Kodit të Ri, të cilat priten të kenë impakt në marrëdhëniet e biznesit me administratën doganore janë: deklaratimet në doganë; mundësitë për aplikim për procedura të thjeshtëzuara; regjimet e ndryshme doganore; garancionet; mënyra e pagesës; zhdoganimi lokal; komunikimi Biznes–Doganë përmes sistemit elektronik; informacioni i detyrueshëm tarifor, rishkrimi i masave për shkeljet administrative të kodit, përkufizimi i veprës penale të kontrabandës dhe evazionit fiskal, mundësia e vetë-zhdoganimit të mallit nga subjektet e Autorizuar, procedura pa letër, apo garantimi i një ekuilibri midis detyrimit të Agjentit Doganor për zbatimin e duhur të legjislacionit doganor dhe të drejtës së operatorëve ekonomikë për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë.

Të gjitha këto janë risi të cilat janë inkorporuar në Kodin e ri të Doganës dhe Akcizës që do të shkojnë në favor të biznesit përmes të cilave përherë të parë biznesi bëhet vendimmarrës në procedurë doganore duke eliminuar diskrecionin e oficerit doganor siç ka qenë në të kalurën. Kjo pa dyshim rrit transparencën dhe llogari-dhënien e të dy palëve Biznes–Doganë, dhe eventualisht përkthehen në masa lehtësuese të të bërit biznes në Kosovë.